



REPUBLIKA E KOSOVË REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Urp.	Nr. Prot. B. Prot.
Dep. 20/OPK	Prot. Nr. 01-652/16
Nr. Tabe Nr. Strana Nr. dauter	Data Datum Date
02	19.02.2016



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.02.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3436/15, për z. Valon Vula, Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjakovë, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Valon Vula, Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjakovë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në Ndërmarrjen shoqërore Holding Corporcy "Deva" Sh.A, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi njoftuar zyrtarin e lartë për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Vula, ka deklaruar se nuk ushtron funksion menaxherial në këtë Ndërmarrje shoqërore nga data 21.02.2012, kur edhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Agjencia ka pranuar një shkresë zyrtare (DPKI-03-02-475/16), në të cilën vërtetohet se z. Valon Vula nuk ushtron funksion menaxherial në Ndërmarrjen e lartëcekur.

Pas analizimit të të gjitha fakteve në dispozicion është konstatuar se nuk prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit